



VENDIM
PER LESHIMIN E DESHMISE SE TRASHEGIMISE LIGJORE

Sot, ne Tirane, me date 09.04/2019, une notere Elida Magani, me seli ne Rr:"Presidenti George. W.Bush", Kulla e II, Nr. 24 , e identifikuar me NIPT K41710006U , konform nenit 62/d, nenit 111 e vijues te ligjit Nr.110/2018 date 20.12.2018 "Per Noterine" dhe dispozitat e Kodit Civil lidhur me Trashegimine Ligjore, perpiloj kete deshmi trashgimie mbi bazen e Kerkeses se:

KERKUESE: Enkelejda Kambo, e bija e Nexhdet-it dhe Rukije, e dtl.14.09.1982, lindur dhe banuese ne Tirane, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, e pajisur me Leternjoftimin me Nr.029159888 dhe numer personal I25914096L, lidhja e vecante me trashegimlensesin "e bija"

OBJEKTI: Leshimin e deshmise se trashgimise ligjore per te ndjerin **Nexhdet Kambo**

BAZA LIGJORE : Nenet 317, 318, 318/1, 318/2, 348, 360 e vijues te Kodit Civil te vitit 1994 te ndryshuar, neni 62/d, nenit 111 e vijes te Ligjit Nr.110/2018 date 20.12.2018 "Per Noterine"

KONSTATOJ:

1. Ne baze te Certifikates se vdekjes te leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njesia Bashkiake Nr.5 dt.03.04.2019 (Ne baze te Aktit te Vdekjes nr.110 date 11.03.2019) vertetohet fakti qe i ndjeri Nexhdet Kambo, atesia Osman, memesia Mynyre, shtetesia Shqiptare, seksi mashkull, gjendja civile i martuar, numer personal F61013023B, ka lindur me date 13.10.1956, ne Korçe dhe ka vdekur me date 09.03.2019 ne Tirane.

Ne nenin 318 te Kodit Civil te ndryshuar percaktohet se: "*Trashegimia celet kur vdes trashegimlensesi*". Duke qene se i ndjeri ka vdekur me date 09.03.2019 rrjedhimisht ky eshte momenti i celjes se trashegimise dhe momenti qe percakton ligjin veprues ne kohe "*tempore mortis*".

Ne nenin 318/1 te Kodit Civil te ndryshuar percaktohet se :"*Trashegimia celet ne vendin ku ka pasur vendbanimin e fundit trashegimlensesi. Kur vendbanimi i fundit i trashegimlensesit nuk dihet, trashegimia celet ne vendin ku ndodhet e gjithë pasurija e tij ose pjesa kryesore e saj.*" une noterja, legjitimohem te marr ne shqyrtim kerkesen per leshimin e deshmise se trashgimise ligjore per te ndjerin Nexhdet Kambo, per vete faktin se vendbanimin e fundit e ka patur ne Tirane, Njesia Bashkiake nr.5.

Ne nenin 318/2 te Kodit Civil te ndryshuar percaktohet se: "*Trashegimia rregullohet sipas ligjit te kohes kur eshte celur.*" Leshimi i deshmise se trashegimise ne te cilin percaktohet rrethi i trashegimtareve ligjore dhe pjeset e tyre takuese do te behet ne baze te ligjit 7850 date

29.07.1994 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar dhe Ligjit Nr.110/2018 date 20.12.2018 "Per Noterine".

2. Kerkuesja Enkelejda Kambo se bashku me kerkesen ka paraqitur provat shkesore ne baze te ciles kerkon te provoje faktin e vdekjes, te te ndjerit Nexhdet Kambo, rrethin e trashgimtareve ligjore dhe pjeset takuese perfituese nga trashgimia e trashgimlensesit.

Pasi paralajmerova kerkuesen per pergjegjesine penale qe ka per vertetesine e provave shkesore qe kerkon ti marr ne shqyrtim, une noterja konform nenit 62/d, nenit 111 e vijues te ligjit Nr.110/2018 date 20.12.2018 "Per Noterine" vendos te filloj procedimin per marrjen ne shqyrtim te provave per leshimin e deshmise se trashgimise ligjore per te ndjerin Nexhdet Kambo.

2.1) Ne baze te Certifikates se vdekjes te leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njesia Bashkiake Nr.5 dt.03.04.2019 (Ne baze te Aktit te Vdekjes nr.110 date 11.03.2019) vertetohet fakti qe i ndjeri Nexhdet Kambo, atesia Osman, memesia Mynyre, shtetesia Shqiptare, seksi mashkull, gjendja civile i martuar, numer personal F61013023B, ka lindur me date 13.10.1956, ne Korçe dhe ka vdekur me date 09.03.2019 ne Tirane.

Kerkuesja konfirmon se nuk eshte ne dijeni qe i ndjeri te kete lene testament, te kete disponuar per te bere te pa denje asnje nga trashgimtaret ligjor, ose ndonje nga trashgimtaret ligjore te kete hequr dore nga e drejta per te trashguar. Ne baze te nenit 330 te KC trashgimia fitohet me vdekjen e trashgimlensesit.

Ne nenin 361 te Kodit Civil te ndryshuar percaktohet se *"Ne rradhe te pare thirren ne trashegim femijet dhe bashkeshorti i afte ose i paafte per pune, duke trasheguar secili ne pjese te barabarta. Kur nje nga femijet ka vdekur para trashegimlensesit, eshte bere i padenje per te trasheguar, ka hequr dore nga trashegimi, ne vend te tij hyjne me zevendesim femijet e tij dhe kur per shkaqet e mesiperme nuk mund te jene trashegimtare, vijne ne trashegim te paslindurit e tyre pa kufizim. Ne kete rast pjesa e prindit qe nuk trashegon, ndahet ndermjet te paslindurve ne pjese te barabarta....."*


Trashegimlensesi Nexhdet Kambo ne momentin e vdekjes, ka qene i martuar dhe ka patur bashkeshorten dhe 2 femije te gjalle.

Sipas Certifikates familjare te leshuar me date 03.04.2019 nga Zyra e Gjendjes Civile, Njesia Bashkiake Nr.5 (Ne baze te regjistrit kombetar te Gjendjes Civile te vitit 2010) dhe ne plotesim te kriterave te parashikuara ne Ligjin "Per Noterine" rezulton se:

Trashegimtare ligjore te radhes se pare te te ndjerit Nexhdet Kambo jane:

-**Rukije Kambo**, atesia Selim, memesia Zybejta, seksi femer, e dtl.02.01.1957, lindur ne Elbasan dhe banuese ne Tirane, me shtetesi Shqiptare, me numer personal F75102035E, gjendja civile e ve, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, lidhja e vecante me trashgimlensesin **"bashkeshortja"**

- **Enkelejda Kambo**, atesia Nexhdet, memesia Rukije, seksi femer, e dtl.14.09.1982, lindur dhe banuese ne Tirane, me shtetesi Shqiptare, me numer personal I25914096L, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, gjendja civile e martuar, lidhja e vecante me trashgimlensesin **"e bija"**


-**Erisa Kambo**, atesia Nexhdet, memesia Rukije, seksi femer, e dtl.14.09.1984, lindur ne Elbasan dhe banuese ne Itali, me shtetesi Shqiptare, me numer personal I45914040J, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, gjendja civile e martuar, lidhja e vecante me trashgimlensin “*e bija*”

Ne baze te nenit 361 te KC te ndryshuar si trashgimtare ligjore te radhes se pare dhe pjeset takuese rezultojne:

- | | |
|--|------------------------------------|
| 1. Rukije Kambo, atesia Selim, memesia Zybejte | <i>bashkeshortja, me 1/3 pjese</i> |
| 2. Enkelejda Kambo, atesia Nexhdet, memesia Rukije | <i>e bija, me 1/3 pjese</i> |
| 3. Erisa Kambo, atesia Nexhdet, memesia Rukije | <i>e bija, me 1/3 pjese</i> |

3. Ne referim te provave te administruara kerkesa eshte bazuar ne ligj dhe ne prova dhe si e tille duhet pranuar,

PER KETO ARSYE,

Bazuar ne Nenet 317, 318, 318/1, 318/2, 348, 360 e vijues te Kodit Civil te vitit 1994 te ndryshuar, neni 62/d, nenit 111 e vijes te Ligjit Nr.110/2018 date 20.12.2018 “Per Noterine”

VENDOSA

- Pranimin e kerkeses si te mbeshtetur ne ligj e ne prova.

- Leshimin e deshmise se trashgimise ligjore per trashgimlensin Nexhdet Kambo, atesia Osman, memesia Mynyre, vdekur me dt.09.03.2019 ne Tirane.

- Caktimin si trashgimtare ligjore te radhes se pare te trashgimlensit Nexhdet Kambo me pjese takuese:

- | | |
|--|------------------------------------|
| 1. Rukije Kambo, atesia Selim, memesia Zybejte | <i>bashkeshortja, me 1/3 pjese</i> |
| 2. Enkelejda Kambo, atesia Nexhdet, memesia Rukije | <i>e bija, me 1/3 pjese</i> |
| 3. Erisa Kambo, atesia Nexhdet, memesia Rukije | <i>e bija, me 1/3 pjese</i> |

Sipas pjeses se tyre takuese trashgimtare ligjore trashegojne te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga trashgimia e trashgimlensit Nexhdet Kambo.

Ky vendim u redaktua ne 5 kopje origjinale, nje kopje e cila do te mbahet ne arkivin e noteres.

U shpall ne Tirane, sot me dt. *20.12.2019* /2019

NOTERE
Elida MAGANI